



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON 10/12/2024

PRIMLJENO

Mr.No. 02/44 L



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



PROCESVERBAL

i mbledhjes së -II- (dytë) urgjente të Kuvendit Komunal të Malishevës

Mbledhja u mbajt me datë: 28.09.2024 dhe filloi në ora: 11:30.

Në mbledhje morë pjesë: 22 asambleistë, Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, Kryetari i Komunës Ekrem Kastrati, drejtori për Bujqësi Sylë Dukolli, drejtori për Buxhet dhe Financa Blerim Thaçi, drejtori për Inspektoriat Hafir Rexha, drejtori për Shërbime Publike dhe Emergjencë Rifat Mazreku, drejtori për Planifikim, Mjedis dhe Urbanizëm Avdi Morina, drejtoresha për Arsim dhe Edukim Arbreshë Krasniqi, përfaqësues nga OSBE dhe zyra për informim.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Meqenëse jemi në seancën e parë pas ndarjes nga jeta të ish ushtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, veteranit të luftës, ish nënkryetarit të Komunës, drejtorit të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, ju ftoj të mbajmë një minutë heshtje. Lavdi!

Hapi mbledhjen e dytë urgjente, që pikë të vetme të rendit të ditës kemi shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës nr.04/775, datë: 30.08.2024, e parashtruar nga kryetari i komunës për projekt buxhetin për vitin 2025 dhe 2027 në tekst të veçantë për vitin 2025. Të pranishëm jemi 22 anëtarë që do të thotë kemi kuorum dhe mund të vazhdojmë me punimin e seancës. Kush është për miratimin e rendit të ditës?

Me 16 vota për, 7 vota kundër dhe 1 abstenim, Kryesuesi konstaton që u miratua ky rend i ditës:

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/775, datë 30.08.2024 e parashtruar nga kryetari i komunës për projekt buxhetin për vitin 2025/2027 në theks të veçantë për vitin 2025.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, kryetar!

Ekrem Kastrati (Kryetari i Komunës): I Shprehi ngushëllime familjes Berisha nga Gurbardhi, për humbjen nga kjo jetë të Hajdin Berishës!

Gjithashtu dhe asambleistit Hasim Rudi sot i ka vdekur babi dhe i shprehi ngushëllime!

Falënderoj të gjithë për pjesëmarrjen në mbledhjen e kuvendit, jeni përgjigjur pozitivisht ftesës së kryesuesit për të shqyrtuar kërkesën time, të cilën e kam parashtruar konform kompetencave ligjore të kryetarit të komunës, e që ka të bëjë me miratimin e projekt-buxhetit të Komunës së Malishevës për vitet 2025-2027, me theks të veçantë për vitin 2025.

Mbledhja e sotme është e një rëndësie të veçantë për komunën tonë dhe interesin e përgjithshëm të qytetarëve tanë, për të thënë më të mirën është më e rëndësishmja që legjislatura e institucionit tonë mban gjatë një viti kalendarik, për faktin së këtu vendoset për investimet e qeverisjes komunale për vitin në vijim.

Komuna e Malishevës në vitin 2025 ka një buxhet me vlerë 21,499,545.01E, që krahasuar me vitin e kaluar kemi një buxhet mbi 1.7 milion euro më të lartë. Mirëpo, kjo rritje lidhet direkt në kategorinë paga dhe shtesa. Pra, dua ta theksoj për ju dhe për të gjithë qytetarët tanë se ky buxhet është jo populist, por është buxhet që në fokues ka zhvillimin ekonomik, vazhdimin e investimeve në qendër, gjithnjë në funksion të jetësimit të projektit tonë të përbashkët për Malishevën Urbane, për të cilën na kanë dhënë besimin dhe qytetarët e komunës sonë.

Në buxhetin për vitin 2025 nga Granti qeveritar janë 19,994,019,01E dhe nga të hyrat vetanake 1,505,526.00E, me rritjen të të hyrave vetanake prej 588,677E, të shpërndara në 5 kategori ekonomike.. Në kategorinë paga dhe shtesa janë të planifikuara 11,713,202.00E për 1372 të punësuar. Në kategorinë e shpenzimeve komunale janë 600,000,00E. Te kategoria e subvencioneve kemi planifikuar 600,000.00E si dhe kategoria e fundit për nga renditja por mjaft e rëndësishme për zhvillimin e komunës sonë është kategoria e investimeve kapitale, ku janë planifikuar saktësisht 6,063,143,00E, që krahasuar me vitin aktual kemi rreth 232 mijë euro më shumë.

Siç e dimë pjesa më e madhe e buxhetit të komunës është ndarë në 3 programe kryesore, konkretisht programin për arsim, program për shëndetësi, si dhe programi për administratën komunale.

Të nderuar ky projekt buxhet është më modifikime shumë të vogla. Jam plotësisht i vetëdijshëm se një pjesë e madhe e mjeteve për investime kapitale janë të parapara për projektin tonë të madh të sheshit, i cili dita ditës po merr formën që meriton dhe realizimin e së cilit mezi janë duke e pritur gjithë qytetarët pa dallim. Po ashtu pajtohem plotësisht që investimet në qendër edhe për vitin vijues do na kufizojnë me investime në fshatra, pra për të qenë i sinqertë me vullnetin më të madh secili fshat e lagje e komunës sonë do e kishim prekë më investime sipas nevojës, por në këto rrethana ki fokuesi jonë aktualisht është në projektin me të madh në gjithë historikun zhvillimor të Malishevës, atë të sheshit së bashku me parkingun nëntokësor.

Por, ju shprehë gjithë gadishmërinë time që si kryetar i Komunës së Malishevës, pavarësisht kësaj, do të jem shumë i gatshëm që kërkesat tuaja për projekte me interes për qytetarët tanë, apo për zgjidhjen e problemeve nëpër fshatrat tona apo këtu në qytet, gjë nuk kanë gjetur hapësirë në këtë projekt-buxhet, ju siguroj se do

të bëjmë maksimumin për ti përkrahur në të ardhmen e afërt.

Jam plotësisht i vetëdijshëm se anekënd komunës sonë ka nevojë për me shumë investime kapitale, për me shumë përkrahje thuajse në secilën fushë zhvillimore, por mundësitë tona buxhetore janë paksa të kufizuara.

Ju siguroj se për asnjë moment nuk do të ndalem për shumë projekte me interes për komunën dhe qytetarët tanë, të cilat në komunë nuk kemi mundësi buxhetore për ti jetësuar, do ti

drejtohem për të gjetur përkrahje institucioneve qendrore, duke mos lënë anash edhe donatorët dhe partnerët tanë ndërkombëtar.

Prandaj, duke pasur ne konsiderate se miratimi i buxhetit është edhe obligim i yni ligjor, kërkoj nga ju që pas kontributeve që mund të jepni në këtë seancë, ne fund të përkrahni miratimin e këtij Projekt Buxheti të Komunës së Malishevës për vitin 2025/27, me theks te veçante për vitin 2025.

Më lejoni te theksoj se qe nga viti 2022 ku ne kemi nisur te punojmë si qeverisje komunale e dale nga zgjedhjet e fundit lokale, kemi një rritje te buxhetit ne vlerë prej mbi 5.7 milion euro, apo thënë me thjeshte, ky buxhet është 26.91% më i lartë se sa buxheti i dy viteve më pare, pra gjithënjë po flas për periudhën e mandatit tonë qeverisës.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Sot jemi në ditë vikendi dhe jemi para votimit të buxhetit, që konsideroj vendimi më rëndësishëm i komunës në nivel komunal, i cili përcakton ku do të shkojë buxheti për 4 vitet e ardhshme. Është bërë praktik e jona që ne këto ditë me thirr seanca të jashtëzakonshme, urgjente duke pasur parasysh që 30 shtatori është afati i fundit dhe në presion të vazhdueshëm ndaj anëtarët e kuvendit, ndaj anëtarëve të KPF-së që ju ta mbani një takim në ora 17:00, sikur të kish ndodh diqka e jashtëzakonshme në këtë kuvend. Kryetar, kryesues ju e dini mirë që buxheti duhet të miratohet me 30 shtator dhe planifikimet duhet të ndodhin me kohë dhe jo ti thërrisni njerëzit me presion që të vinë ta bëjnë kuorum në KPF-ë. Kryetar, je zotu që ne do të kemi bashkëpunim me të gjithë ju, mirëpo ky nuk është bashkëpunim. Asnjëherë nuk e ke thirr një anëtar të grupit ose një kryesus të grupit që ti marrësh një mendim rreth projekt buxhetit. Kryetar, kam menduar që ti do jesh ndryshe në qeverisje, por jo në këtë formë që ti të ju japësh presion njerëzve. Kryetar, keni pasur kohë 1 vit që ta përgaditisni në kohën e duhur dhe në momentin e duhur dhe jo të na vijë në seancën e së shtunës por në seancë të rregullt. Ne nuk jemi me blloku qendrën dhe asnjë projekt tjetër në nivel komune, por të na vendosesh para aktit të kryer dhe unë duhet me qenë kundër këtij projekt buxheti. Kryesuesi e thirr dy herë brenda një dite seancën e KPF-së. E thirr në ora 13:30 nuk i bëhet kuorumi dhe pastaj e thirr në ora 17:00 dhe sigurisht që kjo nuk do të kalon pa interpretim ligjor në MAPL-ë. Jeni duke na degraduar neve si anëtarë të kuvendit dhe si qytet. Kryesus, për çështjen e thirrjes së KPF dhe kuvendit ne do kërkojmë interpretim në MAPL.

Unë mendoj që ky projekt buxhet ka përsëritje të investimeve. Kryetar, kolektori prapë përsëritet. Çka ka ndodhur me kolektorin kryesor, pse në vitin e kaluar nuk ka filluar në kohën e duhur? Një kohë të gjatë e keni bllokuar dhe kompaninë fituese e cila nuk ka mundur ti kryej shërbimet, dhe pse nuk ka mundur ti kryej shërbimet e dini ju shumë mirë.

Në buxhet ka investime pa specifika, nuk i tregon rrugët, nuk i tregon metrat dhe unë mendoj që ky projekt buxhet është shabllon që ti me mundur me i lëvizë të gjitha ato projekte nga do që e ke interesin ti.

Kryetar, asnjë burs për student nuk është ndarë, për vitin 2025 në qfarë forme do të shkoni a do të ndahen bursa sepse në nivel të komunave vetëm komuna e Malishevës nuk ka ndarë bursa. Te të punësuarit me kontrata mbi vepër, nga cila kategori paguhen dhe në çfarë forme po merren, a ka shkelje ligjore brenda kësaj. Kjo shkon dhe për kualicionin qeverisës LDK-në.

Drejtor, tek dëgjimet publike- zotimi yt dhe i kryetarit këtu që dëgjimet publike do të mbahen në

çdo bashkësi lokale dhe do merr pjesë dhe Komiteti për Politikë e Financa. Sa e di unë 80% e fshatrave i keni të anashkaluara nga dëgjimet publike, arsyet pse nuk keni shkuar i dini ju sepse i keni ikur ballafaqimit direkt me qytetarin. Drejtor, dëgjimet publike është dashur të mbahen në q_ do bashkësi lokale.

Kryetar, ka shumë shkolla të reja që keni ndarë mjete prapë për renovimin e tyre. Pres përgjigje për këto që i parashtrova.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Si KPF-ë ne e kemi thirrur dëgjimin publik, i cili ka qenë i paraparë të mbahet në sallën e asamblesë komunale me datë: 19.09.2024, shtatë ditë ka qenë në konsultim publik dhe shqetësimi është këtu që asnjë anëtar i opozitës nuk ka qenë prezent për ti bërë propozimet ose shqetësimet e tyre, gjë që sot kanë mundur me u harmonizuar në këtë projekt buxhet ashtu siç e parasheh dhe ligji. Ndonjëherë është mirë ta kritikojmë dhe vetën, jo vetëm palën kundërshtare. Sa i përket mbledhjes së KPF-së është thirrur një herë mirëpo për shkak të mungesës së kourumit është shtyrë për në ora 17:00. Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Shprehi ngushëlime familjes Berisha dhe gjithë qytetarëve të komunës së Malishevës për humbjen e Hajdin Berishës!

Hajdin Berisha ka qenë dhe do të mbetet shembulli më i mirë i gjithë qytetarëve sidomos ata që kanë përgjegjësi para vete së pari se si duhet të silleni me familje, me shoqëri dhe si duhet ta mbrojmë vendin. Nga ardhja e ti si drejtor i shëndetësisë ka qenë shembulli më i mirë i cili ka lënë familjen, të afërmit dhe 90% të kohës ia ka kushtuar qytetarëve të komunës së Malishevës. Hajdini ka qenë trajtues i barabartë i gjithë qytetarëve të Malishevës.

Është shqetësuese që sot është ditë vikendi dhe ne ftohemi në një seancë urgjente, kur ne e dimë që ky muaj i ka 30 ditë dhe kemi pasur kohë të thirrimit sencën. Projekt buxheti për vitin 2025-2027, me theks të veçantë për vitin 2025, buxhet për interesat e qytetarëve nuk mundet me qenë sepse ky projekt buxhet nuk është diskutur nëpër fshatra, nuk është marr mendimi dhe opinionimi i qytetarëve. Këtë projekt buxhet mund ta quaj që është projekt buxhet i grupeve të caktuara të interesit ose i kafeve dhe jo projekt buxhet i qytetarëve.

Një shqetësim tjetër e kam unë, që shefi juaj, në këtë rast dhe LDK-së që është në pushtet dhe ju NISMA-s, sepse ju e keni një shef të përbashkët, a është i informuar ai që ju me dy këmbët jeni duke i shkelë vlerat e luftës. Është për të ardhur keq se si ka ndodhur në fshatin Gajrak, kur një dëshmori Idriz Gajraku, për 24m nuk i dërgohet asfalti tek shtëpia. Për 70m nuk asfaltohet rruga për spitalin ushtarak, ku shumë dëshmorë e invalid të luftës kemi që janë shëruar aty dhe aty nuk asfaltohet sepse aty nuk marrin vota. Kryetar, unë kërkoj nga ju dhe nga grupi i LDK-së që janë në qeverisje duhet ta njoftoni Fatmir Limaj, shefin e juaj se çka është duke ndodhur.

Tek projekt buxheti kam parë shumë projekte që janë copy-paste dhe që janë projekte fiktive. Trotuari në fshatin Bubël-Damanek-Qypev është nga viti 2016.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Alban, tu kanë ngatërruar nocionet tek shefi dhe kryetari dhe tek postet ndërinstitucionale. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Në emër të grupit të VV-së shpreh ngushëllime për familjes Berisha për humbjen e Hajdin Berishes!

Komplet viti 2024 jam duke e parë që rëndësia, funksioni i këtij kuvendi veç i ka ardhur fundi, nuk e di çka jemi duke bërë si kolegë që se shpërndajmë kuvendi dhe të shkojmë në zgjedhje të

parakohshme. Nga pranvera ende nuk kemi mbajtur ndonjë seancë të rregullt, sepse të gjitha kanë qenë të jashtëzakonshme ose urgjente.

Është projekt buxheti i tretë që e votojmë si legjislaturë dhe vitin e parë të mandatit atëherë buxhetin e kemi trashëguar nga legjislatura e kaluar që nuk është votuar dhe e kemi mirëkuptuar të gjithë që e kemi votu. Më kujtohet mirë që zotim i Kryetarit ka qenë që e kemi nga legjislatura e kaluar nuk kemi mundur me e ndryshu. Vitin e kaluar prapë është votuar me urgjencë dhe këtë vit po dëshiron me u votu kështu në një seancë urgjente, në ditën e shtune. Është e vërtetë që KPF-ja ka ftuar debat publik që nuk kam mundur të marr pjesë për arsye të mia personale, mirëpo rendi do të donte që ky buxhet të votohet në një seancë të rregullt, kohë kemi pasur dhe kërkesa është bërë me 30.09 dhe i kemi pasur 31 ditë në dispozicion dhe jo ditën e fundit. Muharremi, nuk qenka këtu që me marr opinionin e ti se a ka bazë ligjore kjo seancë e thirrur. Shumica e projekteve në këtë projekt buxhet janë të bartura nga vitet e kaluara të cilat nuk po gjejnë zbatueshmëri, nuk e di arsyen pse. Shumica e buxhetit është për investime kapitale dhe diku rreth 50% i merr prapë projekti i sheshit. Ne si grup i kemi pasur vërejtjet tona dhe në të kaluarën për realizimin e projekteve mirëpo në moment që është votuar në kuvend ne jemi pajtuar me atë pjesë, mirëpo nuk pajtoj prapë që shumica e mjetet të shkojnë në atë projekt. Në anën tjetër po mbesin shumë fshatra që ka shumë pak projekte. Në fshatin Lladroc-Tërpezë nuk e di cili ka qenë projekti i fundit, pos një rrugë në lagjen time që është asfaltuar tjetër gjë nuk ka diqka që është realizuar. Të njëjtën gjendje e keni në Tërpezë, në Senik që ka shumë gropa që nuk po mundemi ti mbulojmë për arsye që shumica po shkojnë në projektin kryesor. E kuptoj që është mirë me e përfunduar si projekt, mirëpo pa i diskriminu dhe fshatrat e lagjet. Unë pajtohem me Nebihun që të kërkojmë interpretim ligjor për këtë seancë.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Seancën e fundit të rregullt e kemi mbajtur me 03.09. Urdhëro, Driton!

Driton Kastrati (anëtar nga LDK): Shprehi ngushëllime për familjen e të ndjerit Hajdin Berisha!

Ne meqenëse jemi në kualicion me Nismën Socialdemokrate, si Lidhje Demokratike e Kosovës dhe kemi përgjegjësi dhe ne si subjekt dhe jemi të shqetësuar për mënyrën se si shpenzohen paratë e buxhetit. Ne si LDK-ë i kemi votuar buxhetet e kaluara, poashtu kemi votuar dhe pjesën kryesore të shpenzimit tek sheshi i qytetit dhe tek parkingu, poashtu kemi pasur edhe në buxhetet e kaluar dhe projekte rreth infrastrukturës dhe nëpër fshatra. Urbanizmi nuk do të thotë të koncentrohet projekt buxheti vetëm në qytet dhe shqetësuese është që nëpër fshatra nuk është punuar as sa është paraparë me buxhet. Shqetësimi im është që dhe ato rrugica që janë asfaltuar nëpër fshatra, ose trotualet ka pasur selektive dhe aty ku është punuar është investuar ka pasur elemente të animit politikë dhe diskriminimit. Rreth fjalimit që e dha Albani, se në fshatin Gajrak ka ndodhur një anashkalim për disa metra ku jeton familja e dëshmorit, unë si anëtar i kuvendit dhe në emër të LDK-së nuk pajtohem me këtë qasje selektive. Unë e kam ngritur zërin dhe herave të tjera që në fshatin Turjakë para një viti është filluar të punohet rreth asfaltimit të disa rrugicave që kanë qenë të parapara në buxhet mirëpo në atë ditë që është votuar buxheti të nesërmen makineria që kanë qenë aty duke punuar është tërhequr. Për koiqidencë makineria ka ardhur për të filluar punimet në rrugën ku unë jetoj dhe jo në rrugicat tjera dhe kjo për mua është tendencioze. Unë nuk pajtohem që rrugicat e fshatit Turjakë të punohet vetëm një rrugicë dhe

tjerat të anashkalohen. Para një viti kam ngritur një shqetësim në lidhje me rrugën ku jetoj unë, aty është një kontekst në lidhje me disa mbetje ku një uzurpator që e ka konstatuar dhe zyra për qështje pronësore juridike e komunës, ende ato mbetje qëndrojnë aty dhe ne nuk e dimë se çka do të ndodh me atë rrugë. Unë këtë shqetësim po e përcjelli këtu dhe në emër të familjes dhe lagjes ku unë jetoj sepse ata janë të shqetësuar me këtë qasje. Në dëgjimin publik që e ka organizuar kryetari kaluar unë i kam parashtruar dhe disa pyetje me shkrim në emailin e komunës, poashtu kam qenë prezent në këtë sallë dhe fokuesi im ka qenë kryesisht asfaltimi i rrugëve nëpër fshatra dhe me theks të veçantë për fshatin Turjakë dhe Lubizhdë, për arsye sepse ne i kemi ndarë mjetet për këto rrugë. Përgjigjja e kryetarit në dëgjim publik ka qenë që ato rrugë kanë qenë të përfshira në kuadër të një kontrate dy vjeçare dhe se viti që jemi tash është vit ku ato ose duhet të kryen ose të mbesin. Është mirë që kryetari apo drejtori i urbanizmit dhe inspektoriatit të japin verzionin e tyre pse nuk po përfundojnë ato rrugë dhe kur do kryhen.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Shprehi ngushëllimet familjes Berisha, kryetarit të komunës, kolegëve të tij dhe gjithë neve këtu për vdekjen e kryetarit të Nisma Socialdemokrate në Malishevë, ish nënkryetarit të komunës dhe drejtorit të shëndetësisë Hajdin Berisha. Një personalitet i jashtëzakonshëm me një veprimtari të jashtëzakonshme, qoftë në luftë qoftë pas lufte.

Para kemi një dokument projekt buxhetin e komunës së Malishevës në theks të veçantë për vitin e ardhshëm 2025. Ky projekt buxhet është në frymën e vazhdimësisë së buxheteve të kaluara, frymë kjo që e ka transformuar dhe po e zhvillon ekonomikisht qytetin tonë. Ne sot jemi dëshmitarë që janë më shumë se 200,000.000E që janë duke u investuar për sektorin privat, kryesisht në ndërtimet e objekteve afarist banesor. Mërgimtarët tanë nuk po shkojnë më të investojnë në Prishtinë por kanë filluar të blejnë banesa në objekte afariste në komunën tonë, paraja private është duke u derdhur në komunën tonë dhe për me u derdh kjo para publike në komunën tonë ka ndikuar që kjo para e vogël publike me u orientu në mënyrë e duhur që të bëhet pak më atraktive qytetin tonë. Këto dilemma i kemi pasur për buxhetin dhe vitin e kaluar, mirëpo ne e kemi parë efektin e këtij buxheti në projektin e bulevardit "Ibrahim Mazreku", janë liruar në masë të madhe hapësirat publike. Ne e dimë si ka qenë vitin e kaluar ky shesh dhe si do të bëhet vitin e ardhshëm që do të jetë më atraktiv për qytetin. Unë jam pro këtij buxheti, sepse ky buxhet është në frymën që të bëhet qyteti jonë sa më atraktiv.

Kryeuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëlinda!

Mirëlinda Gashi (anëtare nga PDK): Shprehi ngushëllim familjes Berisha për humbjen e Hajdin Berishës, në të njëjtën kohë shprehi ngushëllim dhe për dy familjet, familjes Krasniqi dhe familjes Kryeziu që komuna e Malishevës ka humbur dy nxënës!

Kur është pika si sot projekt buxheti keni kujdes qa po folim, sepse qytetarët presin shumë nga ne, keni kujdes se çka po del nga këtu. Asnjëherë si subjekt nuk kemi qenë kundër projekteve, kundër investimeve. Ne po shohim që është duke u ndërtuar qyteti, mirëpo nuk po e shohim pjesën tjetër jashtë qytetit. Ne këtu jemi duke biseduar për buxhetin dhe jemi komod, mirëpo nuk janë komod ata qytetarë që sot nuk kanë ujë të pijes. Nga fshati Bubavec deri në Balincë nuk kanë ujë të pijes. Kryetar, ti ke mundur me gjetur bashkëpunim me ne, me na ftuar në takim me

diskutu ku jemi dhe këtë nuk e ke bërë. Mos e lejo që tovolinën ta rreh gjithkushi. Si projekt madhor kam prit me qenë ujësjellësi dhe me bërë zgjidhjen e ujit. Këto rrugicat që i kam parë në buxhet nuk kisha diqka që doja ndryshuar sepse ishin gjëra të bartura nga buxheti kaluar. Është dashur të ketë më shumë projekte për qytetarë sidomos për fshatrat e komunës së Malishevës. Kryetar, nga ti kërkoj që të reflektosh dhe mos e le Malishevën për test, të bëhet test në Malishevë siç po bëhet për rrymë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro Vajetë!

Valjetë Hoti (anëtare nga PDK): Te investimet kapitale, i kemi 99% janë projekte që po përsëriten. A e keni menduar që këto projekte që po na përsëriten, neve si komunë po na bënë të kuptojmë që kemi menaxhim të dobët, kemi keqpërdorime, kemi fokusin në të njejta projekte, poashtu dhe fokues në zona specifike. Për këto projektet që po përsëriten nuk kemi pasur asnjë raport se çka është duke u bërë me ato projekte, në cilën fazë kanë arritur projektet që janë të përfshira në buxhet. Kjo tregon që kemi mungesë të transparencës dhe kur ka mungesë të transparencës ka dhe keqpërdorime. A po merren parasysht sygjërimet dhe mendimet dhe atyre që po marrin pjesë në dëgjime publike?

Pyetja tjetër është se a janë paraparë situatat emergjente, çka parasheh komuna jonë, a ka fonde të mjaftueshme?

A keni arritur me dalë me ndonjë analizë se pse po na përsëriten këto projekte?

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Burim!

Burim Paqarizi (anëtar nga PDK): Shprehi ngushëllime familjes Berisha për humbjen e Hajdin Berisha, i cili ka dhënë kontribut gjatë luftës por dhe pas lufte!

Nje projekt buxhet i cili nuk ka të përfshira kërkesat e qytetarëve, si i tillë nuk është dhe i pranushëm, duke e ditur dhe se si parti opozitare nuk jemi të përfshira në asnjë diskutim dhe nuk kemi marrur asnjë ftesë si asamble ose si përfaqësues te partive politike. Kjo nënkupton që mungesa e bashkëpunimit dhe transparencës mes juve kryetar dhe qytetarëve ka një dallim dhe një distancë shumë të largët. Unë dua të ndalem tek disa projekte kryesore të cilat i keni pasur në premtimin tuaj në zgjedhjet e nevojave si kryetar ka qenë qështja e ujit ne e dimë se furnizimin me ujë te pijes qytetarët e Malishevës e kanë nivelin shumë të dobët, nuk ka asnjë lëvizje sa i përket kësaj qështje, nuk kemi parë asnjë takim, asnjë qështje publike sa i përket kësaj qështje.

Në aspektin e infrastrukturës pjesa e punimit të sheshit janë bërë disa punime por plani dinamik i punimeve e shohim çdo ditë ne që punohet me nga 3-4 punëtor. Qfarë është duke ndodhur a do të arrihet të realizohet ose kur do të përfundoj?

Sa i përket infrastrukturës në rrugë apo në fshatra gjendja e tyre është shumë e rënduar dhe çdo seancë unë kam qenë kritik që rrugët në fshatra janë në gjendje shumë të rëndë e kemi diskutuar edhe me drejtorin e urbanizmit duhet të merrret diqka me këtë pjesë nuk ka asnjë lëvizje dhe nuk e kam parë as në buxhet që ka ndonjë lëvizje, por ashtu qështja jetike është dhe ndriqimi publik, ndriqimi publik është në gjendje katastrofale në asnjë fshat nuk punon ndriqimi publik duke filluar nga fshati Dragobili ku nuk punon asnjë dritë nuk punon as në fshatin Marali, Goriq, Pagarushë, komplet rrugët nuk kanë asnjë lloj ndriqimi.

Kam edhe një qështje sa i përket bursave, e vetmja komuna e Malishevës nuk ka dhënë bursa në

vitin 2024, a do të planifikohet apo do të vazhdoj ky trend i keq edhe në vitin 2025. Është mirë që të marrim përgjigje rreth këtyre qështjeve.

Kryesusi Argjend Thaçi: Urdhëro Valon!

Valon Krasniqi (anëtar nga Lista Guxo): I nderuar koleg, fshati Bardh ka ndriqim.

Në cilësinë e asambleistit shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së të ndjerit Hajdin Berisha! Të nderuar kolegë, janë disa njerëz të cilët çdo minutë të jetës së tyre ja kanë kushtuar atdheut duke e rrezikuar dhe shëndetin e tyre në kohë të acarta për gjatë etapave të ndryshme, janë disa njerëz që durojnë shumë padrejtësi të ndryshme, sakrifikojnë jetën por nuk ndalën asnjëherë të vetme, dhe i tillë ishte Hajdini!

Sa i përket buxhetit në vitin 2025-2027, në cilësinë e përfaqësuesit të qytetarëve do të japi opinionin tim. Sot do të duhet të jetë një ditë e veçantë për ne si vendimarrës. Në cilësinë e përfaqësuesit të qytetarëve në vazhdimësi si në mandatin e kaluar, poashtu dhe në atë mandat kërkesat të cilat më janë adresuar mua dhe të njejtat kanë gjetur mirëkuptim në qeverisjen lokale unë kam qenë konstruktiv. Kësaj radhe projektet dhe disa kërkesa të cilat i kam adresuar si propozime si psh parku në fshatin Bardh, asfaltimet e disa rrugëve dhe problemeve të natyrave të tjera kanë gjetur mirëkuptim dhe janë hyrë në projekt buxhet, unë personalisht nuk kam si mos ta votoj këtë buxhet. Vota ime nuk do të thotë asesi që është votë për Nismën, e as për LDK-ën, që po qeverisin në komunën tonë. Vota ime është pro buxhetit, sepse buxheti është i popullit pa dallime dhe bindje politike dhe në këtë rast vota ime pro sot do të thotë që nuk do të jem kritikues ndaj fenomeneve negative në të ardhmen nga se guximi është ajo që duhet të ngrihesh dhe të flasësh e sidomos ajo që kërkohet me guxim dhe ta votoj buxhetin për qytetarët e Malishevës.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima (anëtar nga LDK): Shpreh ngushëllime familjes Berisha, për humbjen e Hajdin Berisha!

Sa i përket projekt buxhetit të vitit 2025, unë nuk e kam shfletuar, për arsye se projekt buxhetet e kaluara, nuk janë inspektu projektet. Janë anashkaluar projektet, ka qenë rruga e Kurritzit në Dragobil dhe nuk është asfaltuar, janë asfaltuar vetëm disa rrugica. Në fshatin Banjë ka filluar me u shtruar dhe e ke lënë dhe tani prapë duhet shtrohet zhavor dhe kjo shkon gjithmonë në dëm të buxhetit. Ke pasur me përfundim rrugën Banjë Lladroc, ke filluar një pjesë të vogël ta shtrosh në zhavor dhe pjesa tjetër e mjeteve nuk e di ku kanë mbetur, vetëm 50.000E kemi bërë ridestinin. Në Carravranë asfaltin i'a ke dërguar vetëm një shtëpie, ke shtruar oborre. Kryetar, nuk e di në këtë projekt buxhet a e ke përfshirë shkollën e Astrazupit, dua përgjigje për këtë.

Kryetar, mbeturinat që i keni larguar vetëm 70m nga vendi në të cilin kanë qenë dhe janë hargjuar më shumë se 3.000E. Kryetar, janë të caktuara pikat, parcelat ku janë për mbeturina nuk jeni marrur me këto pika, po i hudhin mbeturinat kudo. Unë jam anëtar i Komisionit Ekoregjonit, dhe e kam për obligim të flas për mbeturina, mirëpo ti Kryetar, nuk je duke u marr me këtë qështje. Unë kur është projekti i mirë e përkrahi, siç ka qenë sheshi që e kam përkrahur, mirëpo vetëm largoni këto që i keni bërë pa vend që i keni përsëritur prapë. Pasi keni bërë manovrimet të këqija, unë nuk do ta votoj këtë projekt buxhet.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj (anëtar nga PDK): Pjesën që e diskutuam tek dëgjimet publike, ne prapë do të pajtohemi që projektet të merren në bashkësi lokale dhe jo të vjen sa për sy e faqe në kuvend. Projekt buxhetin unë do ta kisha votuar , nëse ti Kryetar, do të na kishe premtuar ujin, ujësjellësin, ta bëjmë zgjidhjen e ujit. Kryesues, në pasdite na vjen buxheti, si mundemi të bëjmë analizimin e buxhetit për 4-5 orë. Kur të fillon buxheti ne e lëshojmë sallën e kuvendit, me të vetmen arsye që ne jemi duke u anashkaluar si opozitë në të gjitha vendimarrjet në kuvendin komunal.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet e Financa): Sa i përket dëgjimeve publike, qarkorja e dytë na ka ardhur me vonësë, sepse vitin e kaluar kemi bërë takime dhe nëpër fshatra, mirëpo për shkak të periudhës së shkurtër neve nuk na është mundësuar të bëjmë dëgjime publike nëpër fshatrat. Nuk është qështje e Drejtorisë së buxhetit me caktuar orarin dhe planin dinamik të punëve. Kontrata e kolektorit është 3 vjeqare dhe kjo do të realizohet. Të gjitha këto projekte që po flisni që janë të përsëritura janë kontrata tre vjeqare, duke pasur parasysh dhe disa rrugë që ende nuk kanë përfunduar.

Rinovimi i shkollave e kam thënë dhe herave të kaluara që janë për mirëmbajtjen e shkollave. Sa i përket qështjes së ujit të pijes nuk është vetëm qështje e komunës sonë sepse varet dhe nga faktorët e tjerë, pasi që ka mungesë të sigurimit ujit të pijes në territorin e Malishevës. Nuk ka asnjë anashkalim të projekteve, por janë projekte nën proces që do të realizohen sepse janë të kontraktume. Rasti në Dragobil do të përfundohet.

Sa i përket oborrit të shkollës në Astrazup, është e parapame për vitin 2025.

Sallën e lëshojnë: grupi nga PDK-ë dhe anëtari nga VV-ja Veton Zogaj.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Të pranishëm jemi 17 anëtarë. Kush është për miratimin e projekt buxhetit?

Me 16 vota për, 1 kundër dhe asnjë abstenim miratohet projekt buxheti për vitin 2025.

Mbledhja përfundoi në ora:12:50.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina

